


DORACAK PËR MËSIMIN NGA LËNDA ZGJEDHORE

ETIKA PËR KLASËN E VI - TË


Dr. Kiril Temkov



DORACAK PËR MËSIMIN NGA LËNDA ZGJEDHORE

ETIKA PËR KLASËN E VI - TË

Dr. Kiril Temkov



БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

Botues:

Byroja e zhvillimit të arsimit

Për botuesin:

Vesna Horvatoviq, *drejtor*

Redaksia:

Ivanka Mijiq, *redaktor përgjegjës*

Ajshe Ajrullai, *anëtar*

Mirjançe Miloshevska, *anëtar*

Recenzentë:

Ilija Leshkovski

Mitko Çeshllarov

Përkthim:

Mivedete Mahmuti

Disejni:

Svetllana Stojçeva

Botoi:

Kiro Dandaro - Manastir

Tirazhi:

150

Shkup, 2010

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека Св. „Климент Охридски“, Скопје

373.3.091.3:17(035)

TEMELKOV, Kiril

Doracakë për lëndër e etikës / Kiril Temelkov : [përkthyes Mivedete Mahmuti], - Shkup ; Byroja e zhvillimit të arsimit, 2010, - 25 str. : 25 cm

ISBN 978-608-206-023-1

а) Етика - Основно образование - Наставни методи - Прирачници

COBIS.MK-ID 84447242

Edukimi në etikë u bë një ndër detyrat dhe përmbytjet bashkëkohore arsimore më aktuale në tërë botën. Ajo u paraqit së bashku me renesancën në rolin e moralit në jetë dhe me zhvillimin e etikës në epokën tonë, kur etika përfjetoi rehabilitim në kuptimin shpirtëror dhe social.

Burimet dhe arsyet për këtë janë pasojat e rënda të sjelljes së pakujdeshshme të njerëzimit. E rezikuar është natyra, mes njerëzve mbisundojnë konfliktet, ekzistojnë shumë rreziqe për ekzistencën e qenieve të gjalla dhe të njeriut, njerëzve u kanosen sëmundje të rënda dhe janë të vendosur para formave të ndryshme të vërasisë. Në të gjitha sferat e ekzistencës njerëzore ka probleme që dalin nga sjellja e keqe dhe e papërgjegjshme e njeriut - në ekonomi dhe në punë, në relacionet sociale dhe në sferën politike, në marrëdhëniet familjare dhe në komunikimin mes gjinive, popujve dhe gjeneratave. Përgjigje reale për këtë ishte nevoja e patjetërsueshme përiplërtëritjen e mendimit dhe sjelljes etike të njerëzve, të përgjegjësisë dhe shkatërrisë për zgjedhje të drejtë mes së mirës dhe së keqes. Në të gjitha fushat sot kërkohet sjellje pozitive dhe e përgjegjshme dhe vendosën norma etike të reja dhe të shprehura, të cilat do ti mbrojnë qëllimet klasike dhe moderne të njerëzimit në drejtim të përmirësimit të sjelljes së çdo personaliteti, mbrojtjen e natyrës, zhvillimin e mjedisit jetësor, mbrojtjen dhe zhvillimin e shëndetit të njeriut, drejtë përmirësimit të të gjithë llojeve të veprimit të njeriut në të gjitha sferat- sociale, familjare, ekonomike, politike etj.

Paralel me atë, ka njoħuri të reja antropologjike dhe psikologjike për strukturën e personalitetit dhe zhvillimin e tij nga qenie heteronome kah qenia autonome. Kuptimi i zhvillimit bashkëkohor të njerëzimit është që njeriu vetë ti sjell normat morale dhe vlerat etike. Për këtë më të rëndësishme janë njoħuritë e Zhan Pijazhe dhe të Lorens Kolberg, të cilët e hulumtuan esencën e zhvillimit etik të personalitetit prej viteve më të reja deri në pjejkuri dhe erdhën deri te zbulime të rëndësishme të shkallëve të zhvillimit moral. Paralelisht me këtë është sqaruar edhe nevoja e një fushe të re peda-

gogjike, e quajtur arsim etik. Arsimi etik e plotëson dhe e mbindërtón edukimin standard moral, i cili paraqet të njoħurit e personaliteti të ri me normat dhe tendencat shoqërore dhe pranimin e tyre dhe adaptimin me të. Arsimi etik duhet kuptuar në kuptimin e gjerë: ajo në esencë është e orientuar drejt personaliteti autonom, i aftë të përballet me problemet e jetës dhe me të gjitha problemet serioze të njerëzimit, e cila ka njoħuri përesencën e etikës dhe është e aftësuar në mënyrë etike ti zgjedh problemet në situata kyçë, dhe të jetës së vet, dhe shoqërisë se vet, dhe tërë njerëzimit. Individu etikisht i arsimuar ka aftësi të formësoj, të zgjedh, të ndjek dhe mbroj qëndrime adekuate aksiolodjike, kurse nga vlerat të krijoj norma efektive morale të sjelljes. Ajo është e nevojshme për gjetjen e personaliteti në proceset e ndërlikuar të jetës bashkëkohor dhe të demokracisë, si dhe në rreziqet e pritura të jetës së ardhshme të njerëzimit, kurse do të mundësoj zgjedhje të problemeve (sic janë kriza ekologjike, kanosjet e luftës, konfliktet sociale, shqetësimet shëndetësore dhe klimatike) me gjetjen e përgjigjeve të mira, me shpalosje publike të propozimeve normative, me lidhjen e njerëzve për pranimin e tyre dhe kryerjes së koordinuar.

Metodika e lëndës së etikës është e riaftësuar në përbajtjet e reja edukative dhe të personaliteti të tē rinxve sot. Në atë metodë kryesore janë dialogu dhe mësimi interaktiv - bashkë me tre metodat edukative -etike: shembulli etik dhe mësimi; paraqitje të pyetjeve përvendosje; dhënia e notës etike. Gjatë kësaj përdoren forma dhe teknika të hulumtimit, parashtrimit dhe evalvimit me qëllim, para se gjithash të aktivizohet personaliteti i ri dhe vetëdija e tij për pranimin dhe përfaqësimin e etikës, përpërparimin e vet dhe për zhvillimin e bashkësive të veta (familja, lidhjet personale, bashkësia lokale, populli, shteti...). Në përbajtjet mësimore në çdo fushë tematike dhe njësi mësimore të etikës e mundur është aktualizimi i problemit, duke pasur parasysh konkretivitetin, gjerësinë dhe aktualitetin e problematikës etike.

LITERATURA

- Dr. Kiril Temkov: Pse dhe si të mësohet etika në arsimimin tonë, në librin Etika, Shkup, Epoka, 1998, faq.152-170.
- Dr. Kiril Temkov: Etika sot, Shkup, epoka, 1998.
- Dr. Jovan Lozanovski: Etika dhe rinia. Idetë dhe praktikat e arsimit teknik në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë, Shkup, Kitano, 2006.
- Dr. Jovan Lozanovski – Format e punës, metodat dhe mjetet e mësimit të etikës në shkollat e mesme, disertacioni i doktorantit, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2001.
- Ilinka Torbovska – Smilevska: Etika si lëndë mësimore në shkollat fillore, punim i magjistraturës, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2002.
- Lubica Topuzoska: Arsimi etik në mësimin klasor, punim i magjistraturës, Shkup, fakulteti filozofik, 2005.
- Lubica Topuzoska: Llojet dhe metodat e arsimit teknik në mësimin klasor, disertacioni i doktoraturës, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2006.
- Kiril Temkov: Etika e kulturës, Shtëpia e kulturës, Kavadar.,
- Etika në shkencën bashkëkohore, disertacioni i doktorantit, Universiteti " Shën Qirili dhe Metodij"Shkup, 2007.
- Dragor Zarevski: Filozofia dhe etika në arsimin bashkëkohor, disertacioni i doktorantit, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2005.

PËRMBAJTJET MËSIMORE NË ETIKËN E KLASËS SË VI

Në Programin mësimor të etikës së klasës së VI ka 3 lëmi tematike, me të cilat janë përfshirë çështjet e rëndësishme për edukimin etik në arsimin fillor:

1. ETIKA DHE MORALI
2. VLERAT ETIKE UNIVERSALE
3. SJELLJA E MIRË

Këto tre tërësi mësimore i mbulojnë çështjet themelore etike me të cilat duhet të njoftohen më të rinxjtë: esenca e etikës dhe moralit, lidhshmëria e përgjithshme e etikës dhe kuptimit të vlerave dhe të vlerave më të rëndësishme klasike dhe bashkëkohore, si dhe çështjet e sjelljes së drejtë morale të të rinxve në fushat themelore të jetës.

Në temën e parë mësimore ETIKA DHE MORALI përpunohen çështjet themelore për kuptimin e etikës dhe moralit dhe për rëndësinë e tyre në jetën e njeriut:

1. Çka është etika
2. Morali
3. Rëndësia e moralit
4. Shën Klimenti i Ohrit

Qëllimi është që nxënësit të nxiten në mënyrë etike të mendojnë dhe ta kuptojnë progresin e etikës në epokën bashkëkohore. Nxënësve ju sqarohen nocionet themelore të etikës, moralit, të mirës dhe së keqes, të drejtës dhe të padrejtës, rregulla dhe norma etike, zgjedhja e etikës, arsimi etik. Njihen me rëndësinë e përcaktimit moral dhe të sjelljes morale në jetën e tyre, me kuptimin e përcaktimit dhe sjelljes pozitive dhe negative. Udhëzohen në rolin e personalitetit në moral dhe në organizimin e jetës së tyre.

Ata njihen me diksionin etik dhe terminologjinë dhe i përvetësojnë termet etike: etike, morale, arsyë, ndërgjegje, vlerë, zgjedhje, normë, si dhe më e vlerave e rëndësishme etike: masë, maturi, kujdes, përkujdesje, jo dhunë, mirëkuptim, tolerancë, dialog, sjellje e mirë.

Përveç asaj, njihen me mendimtarët më të rëndësishëm etik të cilët i krijuan njohurit etike dhe e zhvilluan moralin njerëzor (Aristoteli - krijues i termit "etikë", Nëna Terezë – personalitet më i njohur i moralit bashkëkohor). Njohurit e moralit i aktualizojmë me paraqitjen e ideve të udhëheqësít Lëvizjes nacional çlirimitare të Maqedonisë Goce Delçev. Sidomos paraqitet dhe mësohet kontributi etik i etistit të parë dhe më të rëndësishëm Shën Klimenti i Ohrit, i cili la mësimë morale të theksuara, si Largohu nga e keqja dhe bën mirë, të cilët janë bazë për veprimin tonë moral.

Në temën e dytë mësimore VLERAT ETIKE UNIVERSALE përpunohen vlerat themelore etike të gjithë botës, në të kaluarën dhe sot:

1. Etika në tërë botën
2. Ndershëmëria
3. E vërteta
4. Drejtësia
5. Patriotizmi
6. Etika universale
7. Etika e sotme e shëndetit, e ekologjisë, e informatikës

Theskohet ideja për obligueshmërinë e vlerave morale pozitive dhe ideja e re për vendosjen e një sistemi moral të unifikuar në gjithë botën.

Nga vlerat etike themelore posaçërisht përpunohen ndershëmëria, e vërteta dhe vërtetë dashësia, drejtësia dhe patriotizmi, së bashku me vlerat përcjellëse e drejta, përgjegjësia, ligjshmëria. Theskohet nevoja për pranimin e vlerave morale themelore dhe për përcjelljen e tyre në jetë. Mësimi moral lidhet me shembuj të kulturore dhe të përditshmërisë. Nxënësit mësohen të pajtohen me këto vlera etike dhe t'ju përbahen atyre.

Si tematikë e veçantë përpunohet dukuria e re etike e krijimit të etikës universale të njerëzimit, si sistem etik i ndërlidhur nga vlerat etike më të mira të të gjithë popujve, etist dhe epokave, vlera të së cilëve janë: paqja, toleranca, solidariteti, bashkëpunimi.

Vlerat etike bashkëkohore paraqiten në tre sfera të jetës së sotme: shëndeti, ekologjia dhe informatika. Lëvizjet dhe vlerat etike në këto fusha bëjnë pjesë në më

të rëndësishmet në epokën bashkëkohore. Kështu etika paraqitet në aktualitetin e saj dhe në progresin krijues të vazhdueshëm.

Në temën e tretë mësimore SJELLJA E MIRË përpunohet problematika e sjelljes së drejtë në të gjitha sferat dhe në etikecion dhe në bonton si sjellje shkencore dhe korakte e personalitetit të ndërtuar:

1. Sjellja e mirë
2. Sjellja në familje
3. Sjellja në shkollë
4. Sjellja në mes shokëve
5. Sjellja e mirë në opinion
6. Sjellja e mirë ndaj njerëzve tjerë

Sjellja e mirë është karakteristike e personalitetit të edukuar dhe ndërtuar, i cili din të sillet me arsyet e sipas rregullave të çdo mjedisit dhe situate. Ajo është rezultat i edukimit dhe trajnimit, me të cilat te personaliteti ndërtohet kuptimi i obligimeve si të sillet në frymën e moralit dhe ai i mëson pyetjet, përbajtjet, normat, gjestet, mënyrat e sjelljes pozitive. Me këtë afirmohet respekti i moralit qytetar te personaliteti.

Kategoritë themelore të kësaj sfere etike janë: mirësjellja, participimi aktiv në mjediset dhe në elegancë, si vlera etike - estetike. Bëhet fjalë për rëndësinë e formës së sjelljes, edhe pse është përbajtje etike themelore e respektimit të tjetrit dhe vetërespektit, dinjiteti, serioziteti dhe vlera tjera të ngjashme me rëndësi për komunikimin e personalitetit me të afërmit dhe në mjedisin në të cilin lëviz dhe vepron. Respektivisht, sjellja e mirë është dukuri etike reale e personalitetit në përditshmëri, kurse bontoni kontribuon për kuptim më të mirë të relacioneve mes njerëzve.

Gjatë mësimit të kësaj lëmie nxënësit do të njihen me normat themelore të sjelljes së mirë dhe bontonit, mes të cilave bëjnë pjesë çështjet e kujdesit të higjienës, veshjes, të formës dhe stilit të të folurit, të kryerjes së obligimeve të përditshme dhe të ndërtimit të komunikimit pozitiv me të afërmit etj. Në veçanti do të udhëzohen në kuptimin dhe normat e sjelljes së mirë në familje, në shkollë dhe në mes shokëve

Gjithashtu, do ti njohin normat themelore të sjelljes së opinion dhe sjelljes ndaj tjerëve, sidomos ndaj

atyre që kanë nevoja të posaçme. Sjellja e këtillë e ndërtuar dhe e mirëpritet te çdo personalitet i edukuar dhe e përbën kompleksin e kërkesave themelore morale dhe detyrave në botën e qytetëruar.

Në se cilën temë mësimore duhet të jepet hyrje e shkurtër në problematikë, si hyrje shpirtërore dhe informative në çështjet mësimore. Për çdo njérën nga përmbajtjet mësimore është paraparë tekst themelor me sqarime të esencës etike të asaj tematike, paraqitjen e ndonjë formë etike të rëndësishme ose temë nga ajo sferë, paraqitje e shkurtër e ideve të etistëve të mëdhenj të cilët kontribuon për zhvillimin e atij domeni të moralit (si udhëzim në pasurin personale të zhvillimit etik dhe aktualitetit moral), disa skica leksiku, problemore dhe didaktike, forma metodike për sjellje interaktive pedagogjike etj, e adaptuar në moshën e nxënësve, kurse e aktualizuar në relacion me lëvizjet e reja etike në botë. Kah fundi i tre temave mësimore janë shtuar disa tekste etike të rëndësishme, të cilët e paraqesin mendimin original etik, si dhe përzgjidhje të pyetjeve për përsëritje. Të gjithë këto materiale etike - didaktike janë shans për njojje të të rinxje me materien adekuate mësimore, por edhe mundësi realizimi krijues të njojurive të veta dhe kreativitet të arsimtarit dhe për zhvillimin e kontributit të tij ndaj metodikës speciale të edukatës etike.

Udhëzimet metodologjike dhe ushtrimet në se cilën përmbajtje mësimore mund të përdoren në përmbajtjet tjera të lëndës së Etikës, sepse parimet e vlerave janë të njëjtat në tërë lëndën dhe mundësojnë qasje kreative të arsimtarit dhe të nxënësve drejt përpunimit interaktiv të se cilës përmbajtje mësimore.

LITERATURA

- Dr. Kiril Temkov, Etika për vitin e II arsim i gjimnazit, Shkup, Prosvetno delfo, 2004.
- Dr. Kiril Temkov, Etika për vitin e III arsim i gjimnazit, Shkup, Prosvetno delfo, 2004.
- Dr. Kiril Temkov, Fjalori etik, Shkup, Prosvetno delfo, 2004.
- Dr. Kiril Temkov, Si të bëhesh i mirë – Etika për të rinjtë, Shkup, OHO, 2008.
- Branka Minçeva: Etika universale, Shkup, makavej, 2009.
- Branka Minçeva: Etika e paqes, disertacion doktorate, Fakulteti Filozofik, Shkup, 2008.
- Svetllana Pop-Duçeva: familja dhe arsimi etik, punim magjistrature, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2008.
- Karolina Tërpçevska: Sporti dhe olimpizmi në arsimin etik, punim magjistrature, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2008.
- Gordana Nikçevska: Personaliteti etik i arsimtarit, punim magjistrature, Shkup, Fakulteti Filozofik, 2002.

ORGANIZIMI I MËSIMIT TË ETIKËS NË KLASËN E VI-TË

Është e paraparë që mësimi i etikës në klasën e VI të zhvillohet një herë në javë në tërë vitin, respektivisht 36 orë në vit.

Programi mësimor i Etikës në klasën e VI përmban 3 tema mësimore, kurse për secilën nga ata është e paraparë nga 12 orë zhvillim (=36 orë në vit). Meqë, etika është pjesë integrale e lëndës edukative – arsimore, çdo temë dhe përbajtje shërben për të njëjtin qëllim – vendosjen e kuptimit të problematikës së etikës dhe moralit, njojhen me vlerat themelore dhe bashkëkohore morale dhe me rregullat më të mira të sjelljes së mirë. Në atë kuptim, asnje temë dhe përbajtje nuk ka prioritet, por të gjitha së bashku janë pjesë e edukimit të përgjithshëm etik dhe ndihmojnë në personalitetin e ri të ndërtohet vetëdija dhe vullneti i mirë autentik dhe ai të njoh dhe zbatojë normat pozitive morale të ditës së sotme, të nis të sillet mirë, në fryshtë e moralit të mirë, dhe të aftësohet për kreativitet moral autonom kur do të bëhet personalitet i pjekur.

Në programin mësimore të etikës së klasës së VI në temat mësimore janë paraqitur dhe propozuar 4 dhe më shumë njësi mësimore, si korniza themelore përpunimin e problematikës adekuate morale. Ka mjaft hapësirë përsëritje, kontrollim dhe për aktivitete tjera mësimore.

Arsintari mund në mënyrë kreative të orientojoë dhe të propozoj aspekte të përbajtjes, sipas interesimit të nxënësve dhe aktualitetit të materies mësimore.

Mësimi zhvillohet në klasë. Mund të parashihet zhvendosja e bankave për komunikim më të lirë, e cila është një ndër karakteristikat e metodës mësimore të etikës.

DREJTIMET METODIKE - DIDAKTIKE NË MËSIMIN E ETIKËS SË KLASËS SË VI

Si shembuj për zhvillimin e orëve mësimore të etikës së klasës së VI të arsimit fillor, paraqesim nga dy përbajtje mësimore për njësi mësimore të çdo njërs nga tre temat mësimore.

Shembulli nr. 1 PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM

- 1.1. NJËSIA TEMATIKE: ETIKA DHE MORALI
- 1.2. NJËSIA MËSIMORE: ÇKA ËSHTË ETIKA
- 1.3. LLOJI I ORËS: orë për prezantim të përbajtjeve të reja mësimore

2. QËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- krijimi i atmosferës së këndshme në orën e etikës që të vendoset relacion pozitiv mes pjesëmarrësve në procesin mësimor (në mes arsimtarit dhe nxënësve dhe në mes vetë nxënësve) dhe krijojen kushte për realizimin e qëllimeve dhe efekteve pozitive të arsimit etik ;
- përcaktimi i lëndës së etikës.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
- metoda monologe, dialoge dhe metoda e tekstit.

4. ORGANIZIMI MATERIALË-TEKNIK I ORËS

- Ora realizohet në klasë me renditje klasike të bankave.
- Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumesi, libri Etika e klasës së VI dhe tekste tjera nga revista Kontributet për etikën.

5. ORGANIZIMI I ORËS- FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (10 – 15 minuta)

<ul style="list-style-type: none"> – Njohja me nxënësit 	<p>((5-8 minuta) Arsimtari u prezantohet nxënësve. Nxënësit i prezantohen arsimtarit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> – Marrëveshje për punë dhe bashkëpunim 	<p>(5-7 minuta) Bisedë. Arsimtari i njofton nxënësit me metodologjinë e punës dhe i dëgjon mendimet e tyre, të arriturat dhe propozimet.</p>

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<ul style="list-style-type: none"> – Përcaktimi i lëndës së etikës. – Definimi i termit etikë. – Aristoteli – babai i etikës. – Sqarimi i termeve etike: zgjedhje etike, arsim etik, mënyra e të menduarit etik. 	<p>(5-8 minuta) Bisedë për situata të jetës së përditshme dhe vlerësimi i procedurave, reaksioneve dhe veprimeve si të mira ose të këqija (përdoret forma frontale individuale) (5 minuta) Udhëzimi i nxënësve të punojnë në çifte. Çdo çift duhet të përcaktojnë nga ndonjë cilësi të mirë të njëriut – virtyt. (5 minuta) Diskutim për të mirën; diskutim për shkencën që e humton të mirën.(5 minuta) Arsimtari nxënësve u shpjegon për filozofin Aristotel. (5-10 minuta) Diskutim dhe monolog.</p>
--	---

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5 - 10 minuta)

<ul style="list-style-type: none"> – Përsëritja e njësive mësimore dhe diskutim me nxënësit 	<p>(3 minuta) Përmes parashtrimit të pyetjeve të shkurta dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet.</p>
--	--

Detyrë shtëpie (2-7 minuta)

Nxënësve u jepen detyra të bisedojnë me anëtarët e familjes për moralin. Të shkruajnë (nga një fjali) çka mendojnë për moralin disa nga anëtarët e familjes. Është e preferueshme anëtarët e familjes që do të konsultohen të jenë të qjeneratave të ndryshme.

6. VËRETJTJE E ARSIMTARIT

Shembulli nr. 2

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
 - 1.1. NJËSIA TEMATIKE: ETIKA DHE MORALI
 - 1.2. NJËSIA MËSIMORE: RËNDËSIA E MORALIT
 - 1.3. LLOJI I ORËS: Punëtoria etike

2. OËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

– Paraqitja e mundësive edukative dhe arsimi etik me luajtje të roleve me rëndësi morale. Ajo do të thotë krijimi i interesimit te nxënësit për mësimin etikës dhe ndërtimin e relacionit pozitiv mes nxënësve dhe procesit mësimor (sidomos ne mes nxënësve). Morali zbulohet si përkujdesje e përditshme e çdo personaliteti, me çka zmadhohen efektet e arsimit etik.

– Zgjedhja e etikës dhe pranimi i vlerave dhe qëllimeve pozitive dhe largimi i atyre negative.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
 - metoda monolog, dialogë dhe tekstu metoda.

4. ORGANIZIMI MATERIALO – TEKNIK I ORËS

- Ora realizohet në klasë me renditje të bankave dy nga dy, që të krijohen grupe nga 4 nxënës.
 - Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, letër e trashë për mbështjellje të pakove dhe filomaster, libri Etika e klasës së VI dhe literaturë tjetër.

5. ORGANIZIMI I ORËS - FAZAT

PJESA HYRËS E ORËS (10-15 minuta)

Njohja e nxënësve me qëllimeve të punëtorisë etike	(5 minuta) Arsimtari me nxënësit i parashtrojnë idetë themelore rreth problematikës së moralit dhe përcaktimet për të mirën dhe të keqen.
Marrëveshje për punë dhe bashkëpunim	(5 minuta) Bisedë. Arsimtari i njofton nxënësit me metodologjinë e punës dhe i dëgjon mendimet e tyre, të arriturat dhe propozimet.

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<ul style="list-style-type: none"> – Përcaktimi i vlerave të ndryshme etike (negative dhe pozitive) të cilat do ti përpunojnë nxënësit si (për shembull) respekti, mirëgenia, urjetja, dhuna...(por mund të merret parasysh çdo term etik). – Definimi i detyrës për identifikim dhe përshtkim të përbajtjeve të disa vlerave (pozitive dhe negative) etike. – Zhvillimi i njohurive për termet etike : moral, vepër pozitive dhe negative, mënyra etike e vlerësimit të procedurave. 	<p>(5 minuta)</p> <p>Bisedë për procedurat morale në jetën e përditshme dhe sqarimi se çdo procedurë ka përbajtjen dhe rëndësinë e saj – me kontributet e nxënësve për ndërtimin e përbajtjes dhe rëndësisë së një procedure etike (si shembull për punën e tyre të mëtutjeshme të pavarur).</p> <p>(10 minuta)</p> <p>Nxënësit punojnë në grupe nga 4 veta. Çdo njëri duhet të përcaktojë cilësitet e një procedure të mirë dhe të keqe njerëzore dhe ti shkruej në letrën e trashë dhe ta nxjerrë pasojën themelore morale të asaj sjellje.</p> <p>(10 - 15 minuta)</p> <p>Çdo grup i paraqet posterët e tyre etike me karakteristikat (përbajtjet) të një procedure të mirë dhe të keqe etike dhe e nënizon pasojën e mirë ose të keqe nga një sjellje e tillë morale.</p> <p>(5 minuta)</p> <p>Arsimtari e rezimon punën me nxjerrje të konkluzioneve për rëndësinë e moralit, për zgjedhjen e vlerave morale dhe për pasojat nga procedurat morale të njerëzve dhe për personalitetin.</p>
--	---

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10 minuta)

Përsëritje e përbajtjeve mësimore dhe diskutim me nxënësit	Përmes parashtrimit të pyetjeve të shkurtra dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet. Arsimtari nxjerr evalvrim të punës së nxënësve.
--	--

Detyrë shtëpie (2 minuta)

Nxënësve u jepet detyrë të bisedojnë me anëtarët e familjes për moralin. Të shkruajnë se çka mendojnë disa anëtarë të familjes për ndonjë sjellje morale ose jo-morale.

6. VËREJTJA E ARSIMTARIT

Shembulli nr. 3

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
 - 1.1. NJËSIA TEMATIKE: ETIKA DHE MORALI
 - 1.2. NJËSIA MËSIMORE: SHËN KLIMENTI I OHRIT – JES I JONË ETIK
 - 1.3. LLOJI I ORËS: Punëtoria etike

2. QËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- zhvillimi i respektit ndaj rilindësve dhe etistëve maqedonas;
 - ndërtimi i relacionit pozitiv ndaj arsimit dhe kulturës, bazuar në theksimin e mirësisë;
 - thellimi i njohurive për mësimin etik dhe për mësimet morale të Shën Klimentit të Ohrit.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
 - metoda monolog, dialogë, metoda e tekstit dhe metoda e demonstrimit.

4. ORGANİZİMI MATERIALË – TEKNİK I ORËS

- Ora realizohet në klasë me renditje të bankave në formë të katër tavolinave , e paraparë për punë për 4 grupe.
 - Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumesi, libri Etika e klasës së VI, hamer dhe fllomaster përgatitjen e panove për shpjegim, për ngjitet e panove dhe literaturë tjetër.

5. ORGANIZIMI I ORËS - FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (5-10 minuta)

Dhënia e udhëzimeve për punë : grupi i parë hulumton për jetën e Shën Klimentit; grupi i dytë hulumton për të mësuarit etik të Shën Klimentit; grupi i tretë hulumton për porositë etike të Shën Klimentit; grupi i katërt hulumton për rëndësinë e mësimtit të Shën Klimentit.	Në orën paraprake, kur mësohej për doktrinën etike të Shën Klimentit, nxënësit veç më janë ndarë në katër grupe dhe anëtarët e çdo grupi marrin detyra të ndryshme për hulumtimin vetanak në shtëpi. Arsimtari duke respektuar ndarjen nga ora paraprake, i ndanë nxënësit të ulen në 4 tavolina të ndryshme.
---	---

PJESA KRYESORE E ORËS (30-40 minuta)

Hulumtimi i jetës dhe veprës së Shën Klimentit dhe përcaktimi i rëndësisë së mësimit të tij etik. Prezantimi i rezultateve nga hulumtimi	(5-8 minuta) Nxënësit janë ndarë në grupe politematike – çdo grup ka detyrë të veçantë hulumtuese. Anëtarët e çdo grupe pavarësisht kanë punuar në shtëpi dhe kanë mbledhur të dhëna për hulumtimin e problemit për zgjedhjen e së cilit janë të ngarkuar. Çdo anëtarë i grupit në masë e vendos materialin që e ka përgatitur në shtëpi (foto, tekxt të shkruar, tregime...). Puna grupore: diskutim dhe marrëveshje për shpjegim të problemit. (3-5 minuta) Punimi i posterit. (5-10 minuta) Posteret me sellotejp ngjiten për dërrase, në mur ose pano. Udhëheqësi i zgjedhur i grupit i prezanton rezultatet e hulumtimit. Diskutohet. (Secili prezantim zgjat 4-5 minuta.)
---	--

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5 minuta)

– Sinteza e rezultateve hulumtuese – Evalvimi i të arriturave të nxënësve	(1 minutë) monolog i arsimtarit (2-3 minuta) monolog i arsimtarit, notimi i punës individuale dhe grupore të nxënësve
--	--

Detyrë shtëpie (2-3 minuta)

Të mendohet për porosinë e Shën Klimentit: LAR-GOHU NGA E KEQJA DHE BËN MIRË dhe të shkruhet një shembull i zbatimit bashkëkohor të kësaj porosie.

6. VËREJTJA E ARSIMTARIT

Shembulli nr. 4

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
- 1.1. NJËSIA TEMATIKE: VLERAT ETIKE UNIVERSALE
- 1.2. NJËSIA MËSIMORE: NDERSHMËRIA
- 1.3. LLOJI I ORËS: orë për prezantimin e përbajtjeve të reja mësimore

2. QËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- analiza dhe zbatimi i konceptit dhe përbajtjes së vlerës etike ndershmëri, si një ndër vlerat etike themelore;
- zhvillimi i njohurive etike te nxënësit dhe të përcaktimeve të tyre për veprim etik.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
- metoda monologe, dialoge dhe metoda e tekstit.

4. ORGANIZIMI MATERIALO – TEKNIK I ORËS

- Ora realizohet në klasë me renditje klasike të bankave.
- Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, libri Etika e klasës së VI

5. ORGANIZIMI I ORËS – FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (10-15 minuta)

<p>Rekapitullim i shkurtër i njësisë paraprake : Etika në tërë botën</p>	<p>(5 minuta) Arsintari i nxit nxënësit ta verifikojnë idenë e etikës në tërë botën: - me numër të madh vlerash, prezentë gjithkund.</p>
<p>Udhëzim në përbajtjen e re mësimore –vlerë e rëndësishme ndershmëria</p>	<p>(5-8 minuta) Arsintari kërkon nxënësit të numërojnë vlera të rëndësishme morale të cilat i dinë që të vijnë deri te theksimi i ndershmërisë.</p>

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<p>Përcaktimi i termit vlerë kryesore.</p> <p>Numërimi i vlerave themelore të cilat janë të rëndësishme për jetën bashkëkohore edhe pse disa nga ta kanë rëndësi etike më të gjatë</p> <p>Definimi i përbajtjeve të vlerës ndershmëri.</p> <p>Shpjegimi i rëndësise së ndershmërisë për relacionet njerëzore.</p>	<p>(5-8 minuta) Bisedë për situata të jetës së përditshme në të cilat paraqitet dhe është e rëndësishme vlera e ndershmërisë. (5-10 minuta) Së bashku me nxënësit, vlerësimi i pasojave dhe rëndësia e sjelljes me nder, si dhe të pasojave negative të sjelljes jo të ndershme. (5 minuta) Me hyrjen e arsimtarit, thjeshtësia e termit nder si ideal, vlerë, normë dhe procedurë. (5 minuta) Rezyme e arsimtarit për rëndësinë e vlerës së ndershmërisë si një ndër vlerat themelore morale të mbarë botës.</p>
---	---

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10 minuta)

<p>Përsëritja e përbajtjes mësimore dhe diskutimi me nxënësit.</p>	<p>(5 minuta) Me parashtrimin e pyetjeve të shkurtër dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet.</p>
--	--

Detyrë shtëpie (2-3 minuta)

Nxënësve u jepet detyrë në 3-4 fjali ta përkruajnë si i shohin termet njeri i ndershëm, sportist i ndershëm, tregtar i ndershëm

6. VËREJTJE E ARSIMTARIT

Shembulli nr. 5

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
- 1.1. NJËSIA TEMATIKE: VLERAT ETIKE UNIVERSALE
- 1.2. NJËSIA MËSIMORE: E VËRTETA DHE DREJTËSIA
- 1.3. TIPI I ORËS: punëtoria etike

2. QËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- zhvillimi i relacionit pozitiv ndaj vlerave më të mëdha etike të vërtetës dhe drejtësisë;
- zhvillimi i vetëdijes së patjetërsueshme për ruajtjen dhe realizimin e së vërtetës dhe drejtësisë;
- theksimi i së vërtetës dhe i drejtësisë (dhe të vlerave tjera të rëndësishme dhe universale etike) si bazë për moral të mirë dhe për relacione të mira dhe zhvillimin e bashkësive njerëzore.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
- metoda monolog, dialogë, metoda e tekstit dhe metoda e demonstrimit.

4. ORGANIZIMI MATERIALO – TEKNIK I ORËS:

- Ora realizohet në klasë me renditje të bankave në formë të shkronjës cirilike
- Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, libri Etika e klasës së VI

5. ORGANIZIMI I ORËS - FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (10-15 minuta)

Kontrollimi i obligimeve dhe prezantimi i detyrave të shtëpisë Koment i shkurtër për detyrat e shtëpisë.	Nxënësve, PASIQË paraprakisht janë prezantuar përbajtjet mësimore për të vërtetën dhe drejtësinë, u jepet të mendojnë për ndonjë rast të cilin e llogarisin si karakteristik për ndjekjen e së vërtetës ose të gjenjeshtrës, si dhe ndjekjen e drejtësisë dhe bërjes së të padrejtës. Ai rast me notën duheshe të përshkruhet në 5 fjalë.
---	---

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

Diskutim - Përcaktimi i rëndësisë etike të vlerave etike universale të vërtetës dhe drejtësisë	(5-10 minuta) Përmes bisedës rekapitullim i përcakttimeve themelore dhe rëndësisë së të vërtetës dhe drejtë dashjes. Koment i jomoralitetit dhe të pasojave të këqija nga gjenjeshtra. (5-10 minuta) Rekapitullim i përcakttimeve themelore dhe të rëndësisë së ndjenjës së drejtësisë dhe vlerës së drejtësisë, si dhe të pasojave të këqija nga e padrejta. (5-10 minuta) Përcaktimi i nevojave etike dhe vlerave morale të vlerave të së vërtetës dhe të së drejtës dhe lidhja me vlerën e ndershmërisë.
---	--

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10 minuta)

Evalvimi i aktiviteteve të nxënësve.	(2-3 minuta) Përmes parashtimit të pyetjeve të shkurtra dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet. (2-3 minuta) Arsimtar i noton aktivitetet e nxënësve
--------------------------------------	---

Detyra e shtëpisë (1-5 minuta)

Nxënësve u jepet detyrë të mendojnë për vlerën etike të patriotizmit, për të cilën kanë mësuar në lëndë të ndryshme (histori). Të bisedojnë me prindërit për termin dhe përbajtjen e patriotizmit.

6. VËREJTJA E ARSIMTARIT

Shembulli nr. 6

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
 - 1.1. NJËSIA TEMATIKE: VLERAT ETIKE UNIVERSALE
 - 1.2. NJËSIA MËSIMORE: ETIKA UNIVERSALE
 - 1.3. TIPI I ORËS: orë për prezantimin e përbajt-të reja mësimore

2. OËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- theksimi i nevojës për krijimin e vlerave morale të përbashkëta që do ti lidhin njerëzit e mbarë botës dhe sqarime të procesit si krijohet etika e përbashkët e të gjithë njerëzve;
 - të kuptohen vlerat themelore të etikës universale.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
 - metoda monologu, dialogë, metoda e tekstit dhe metoda e demonstrimit.

4. ORGANIZIMI MATERIJALË – TEKNIK I ORËS:

- Ora realizohet në klasë me renditje të bankave në formë të shkronjës cirilike Π. (që të gjithë nxënësit shikohen në sy)
 - Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, libri Etika e klasës së VI

5. ORGANIZIMI I ORËS - FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (5-10 minuta)

<p>Diskutim për lidhëshmërin e përgjithshme të njerëzve – imponohet ideja se njerëzit mund dhe duhet të jenë shumë fort të lidhur dhe përmes vlerave të përbashkëta (universale) .</p>	<p>Nxënësit për detyrë shtëpie duhej të mendonin dhe të bisedojnë për lidhshmërinë e njerëzve në mbarë botën (ekonomike, kulturore, politike) Pastaj për këtë temë të shkruajnë 5 fjalë.</p>
--	--

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Etika universale- Vlerat themelore universale etike:- Paqe, mirëkuptim, solidaritet, bashkëpunim- Mundësia e individit të ndikojë në zhvillimin e vlerave universale dhe për tejkalimin e dukurive negative në sjelljet e njerëzve.	<p>(5 minuta) Monolog i arsimtarit. Sqarim i termit etika universale dhe të vlerave themelore të etikës universale</p> <p>(5-10 minuta) dialog për nevojën e etikës universale</p> <p>(5-10 minuta) Formohen çifte dhe qdo çift diskuton për një vlerë universale, mundohet ta definoj atë vlerë dhe ta përcaktojë nevojën e zbatimit të përgjithshëm të saj</p> <p>(5-10 minuta) Nxënësit diskutojnë për vlerat universale.</p> <p>(5 minuta) Diskutim</p>
--	---

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Përsëritja e përmbajtjeve mësimore dhe diskutimi i nxënësve- Evalvimi i aktiviteteve të nxënësve	<p>(2-3 minuta) Përmes parashtrimit të pyetjeve të shkurtra dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet</p> <p>(2-3 minuta) Arsimtar i noton aktivitetet e nxënësve</p>
---	--

Detyra e shtëpisë (1-5 minuta)

Nxënësve u jepet detyrë të zbulojnë një vlerë universale në librin që e lexojnë ose në ndonjë tregim televiziv, teatral ose filmit. Në disa reshta ta përshkruajnë vlerën universale të zbuluar.

6. VËREJTJA E ARSIMTARIT

Shembulli nr. 7

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
 - 1.1. NJËSIA TEMATIKE: SJELLJA E MIRË
 - 1.2. NJËSIA MËSIMORE: SJELLJA E MIRË
 - 1.3. LLOJI I ORËS: orë për prezantimin e përbajt-të reja mësimore

2. QËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- sqarimi dhe kuptimi i karakteristikave themelore dhe vlerave të sjelljes së mirë;
 - lidhshmëria e problematikës së sjelljes së mirë me qëllimet dhe vlerat tjera të përgjithshme etike, siç janë vendosja dhe zhvillimi i besimit, respekti dhe solidariteti mes njerëzve, bashkëpjesëmarrësve dhe shokëve;
 - theksimi i kompleksit të normave themelore shoqërore për sjellje të mirë dhe sjellje të mirë në familje, në shkollë, në opinion dhe ndaj njerëzve tjerë.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
 - metoda monolog, dialogë, metoda e tekstit dhe metoda e demonstrimit.

4. ORGANIZIMI MATERIALO – TEKNIK I ORËS

- Ora realizohet në klasë me renditje të bankave në formë të shkronjës cirilike Π, që nxënësit të shikohen në sy dhe direkt të komunikojnë.
 - Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, libri Etika e klasës së VI

5. ORGANIZIMI I ORËS- FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (5-10 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Hyrje në temën e tretë mësimore - Diskutim për përbajtjet e reja në bazë të njohurive etike të deritashme të nxënësve	<p>Rekpitullim i shkurtër i punës së deritashme në etikë dhe lidhja e dy temave mësimore .</p> <p>Udhëzim nxënësve se edhe tema e tretë ka të bëjë me problematikën e njëjtë të dallimit dhe zgjedhjes së të mirës dhe të keqes, vetëm me aplikimin e disa fushave të caktuara dhe sferave sociale .</p>
--	--

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Për problematikën e sjelljes së mirë - Për fushat themelore të sjelljes së mirë – në familje, në shkollë, me shokët, në publikë, ndaj njerëzve tjera	<p>(5-10 minuta) Sqrarimi i esencës së sjelljes së mirë.</p> <p>(5-10 minuta) Karakterizimi – me pjesëmarrje të nxënësve – të sjelljes së mirë sipas vlerave të njerëzisë, përkujdeset për shëndetin dhe eleganca</p> <p>(5-10 minuta) Koment për porosinë e njohur etike: Asnjëherë mos lëndo askënd, çdoherë ndihmo</p> <p>(5 minuta) Shqyrtime përbyllëse me përkujtim të vlerës së faljes dhe traditën e Shën Nike-forus(falja).</p>
---	--

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Përsëritja e përbajtjeve mësimore dhe diskutimi me nxënësit - Evalvimi i aktiviteteve të nxënësve	<p>(2-3 minuta) Me parashtrimin e pyetjeve të shkurtra dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet.</p> <p>(2-3 minuta) Arsimtarë i noton aktivitetet e nxënësve.</p>
--	--

Detyrë shtëpie (1-3 minuta)

Nxënësit duhet të përshkruajnë në 3-4 fjali pse festohet festa e Shën Nikeforus (falja) dhe si falen njerëzit në atë festë.

6. VËREJTJET E ARSIMITARIT

Shembulli nr. 8

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM
- 1.1. NJËSIA TEMATIKE: SJELLJA E MIRË
- 1.2. NJËSIA MËSIMORE: SJELLJA MES SHOKËVE
- 1.3. LLOJI I ORËS: punëtoria etike

2. QËLLIMET E ORËS MËSIMORE:

- vendosja dhe zhvillimi i besimit, respektit dhe solidaritetit mes shokëve;
- udhëzim për normat themelore shoqërore për sjellje të mirë, sjellje njerëzore dhe kulturore në shoqërinë e vetë.

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

- forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;
- metoda monologu, dialogë, metoda e tekstit dhe metoda e demonstrimit.

4. ORGANIZIMI MATERIALO – TEKNIK I ORËS

- Ora realizohet në klasë me renditje të bankave në formë të shkronjës cirilike Π, që nxënësit të shikohen në sy dhe të komunikojnë drejtëpërdrejtë.
- Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, libri Etika e klasës së VI

5. ORGANIZIMI I ORËS - FAZAT

PJESA HYRËSE E ORËS (5-10 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Prezantimi gojor i detyrate të shtëpisë- Diskutimi	<p>Nxënësve, në orën paraprake të prezantimit të njofurive të reja për sjellje të mirë në mes shokëve, i u është dhënë të shkruajnë 5 rreshta për një ngjarje, kur ata duhet ta prezantojnë shokun e tyre, shoqen a një personi të rritur dhe të rëndësishëm. Si e kanë bërë atë? A kanë pasur rregull për një prezantim të tillë? A kanë pasur satisfaktion që kanë shok/shoqe të mirë?</p>
---	--

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<p>- Për pyetjet e shoqërisë diskutohet për disa aspekte:</p>	<p>a) për shokët e shkollës: - raporti me shokët në orën e mësimit; - raporti me shokët në kohën e pushimit; - raporti me shokët e shkollës jashtë shkollës.</p> <p>b) Për shokët prej fëmijërisë:shokët (moshatarët) e familjes; shokët nga klubet sportive ose nga ndjekja e përbashkët e ndonjë kursi (gjuhë, muzikë etj).</p> <p>c) raporti me më të vjetrit dhe me shokët më të rinj; kërkimi dhe dhënia e ndihmës, vizita dhe pranimi i vizitave në shtëpi, si të fitohet dhe të ruhet besimi, zbulimi dhe ruajtja e fshehtësisë, çka të bëhet kur shoku bën diçka çka nuk është mirë ose nga i cili veprim mund të dëmtohet ndonjë individ.</p> <p>ç) Si të ruhet shoqëria?</p>
---	---

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Përsëritja e përmbajtjeve mësimore dhe diskutimi me nxënësit- Evalvimi i aktiviteteve të nxënësve	<p>(2-3 minuta) Me parashtrimin e pyetjeve të shkurtra dhe konkrete, materiali mësimor sintetizohet</p> <p>(2-3 minuta) Arsimtari i noton aktivitetet e nxënësve.</p>
--	---

Detyra e shtëpisë (1-5 minuta)

Nxënësit duhet të bisedojnë me anëtarët e familjes për përvojat e tyre të shoqërimit në fëmijëri.

6. VËREJTJA E ARSIMITARIT

Shembulli nr. 9

PËRGATITJA PËR ORËN MËSIMORE TË ETIKËS

1. TË DHËNA PËR IDENTIFIKIM

1.1. NJËSIA TEMATIKE: SJELLJA E MIRË

1.2. NJËSIA MËSIMORE: SJELLJA E MIRË ME NJERËZIT TJERË (SIDOMOS NDAJ NJERËZVE ME NEVOJA TË POSAÇME)

1.3. LLOJI I ORËS: orë për prezantimin e njohurive të reja

2. QËLLIMI I ORËS MËSIMORE:

– udhëzimi për nevojën e njeriut të sillet mirë me njerëzit tjerë, sidomos ndaj atyre me nevoja të posaçme;

– të vihet deri te njohuritë se në njerëzimin bashkëkohor shumë insistohet në sjellje e mirë dhe në përparrimin e përkujdesët njerëzor për individët me nevoja të posaçme (invalidë, të hendikepuar)

3. FORMAT DHE METODAT MËSIMORE:

– forma mësimore frontale, individuale dhe grupore;

– metoda monolog, dialogë, metoda e tekstit dhe metoda e demonstrimit.

4. ORGANIZIMI MATERIJALO – TEKNIK I ORËS:

– Ora realizohet në klasë me renditje klasike të bankave.

– Nga mjetet mësimore përdoren: tabela, shkumësi, libri Etika e klasës së VI

5. ORGANIZIMI I ORËS - FAZAT:

PJESA HYRËSE E ORËS (5 -10 minuta)

Përcaktimi i renditjes së paraqitjeve sipas përbajtjes së hulumtimit	Nxënësit kishin për detyrë shtëpie të hulumtojnë si duhet të jetë sjellja ndaj njerëzve tjerë sot, sidomos ndaj individëve me nevoja të posaçme. A ka shumë njerëz me nevoja të posaçme? Cila është përvoja e tyre personale në sjelljen me ata?
--	--

PJESA KRYESORE E ORËS (25-35 minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Bisedë e përgjithshme për temën- Rekapitullim çfarë lloj njerëzish me nevoja të posaçme ekzistojnë: të shurdhër, të verbër, me pengesa në lëvizje, me lëndime në kokë	<p>Nxënësit i shpalojnë njohurit e tyre për raportet me njerëzit tjerë. Arsimtari i shënon në tabelë normat themelore të sjelljes së mirë ndaj njerëzve tjerë.</p> <p>Pastaj shqyrtohet vallë dhe sa bëhet kujdes për të hendikepuarit dhe vallë sjellja e mirë me ata është etikisht e rëndësishme. Sjelljen konkluzione për sjelljen e mirë të përbashkët ndaj të hendikepuarëve.</p>
--	---

PJESA PËRFUNDIMTARE E ORËS (5-10minuta)

<ul style="list-style-type: none">- Sintezë e njohurive të fituara- Evalvimi i aktiviteteve të nxënësit	<p>(2-3 minuta) Monolog i arsimtarit.</p> <p>(2-3 minuta) Arsimtari i noton aktivitete e nxënësve.</p>
--	--

Detyra shtëpie (1-5 minuta)

Nxënësve u jepen sqarime përfundimtare nga Programi mësimor i etikës dhe udhëzohen që ti kontrollojnë materialet mësimor të kaluara dhe të pregaditen për rekapitullimin tematik të temës mësimore: sjellja e mirë, si dhe për rekapitullimin global të të gjitha përbajtjeve mësimore, sidomos të termeve themelore etike e mira dhe keqja.

6. VËREJTJA E ARSIMTARIT

PËRCJELLJA DHE NOTIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE NË MËSIMIN E ETIKËS PËR KLASËN E VI

Mësimi i etikës së klasës së VI duhet të mundësojë që të fillojë krijimi i vetëdijes etike qytetare te çdo nxënësi, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë personale pér sjelljet, mësimin dhe aktivitetet tjera të nxënësit. Qëllimet dhe detyrat e edukimit etik janë të lidhura me zgjedhjen e çështjes së rëndësishme të sjelljes morale të personalitetit dhe janë të orientuara drejt zhvillimit të vullnetit të mirë, të relacionit pozitiv drejt jetës dhe drejt njerëzve, të përgjegjësisë së nxënësit dhe të dinjitetit si dhe vetë-respektit të tij/saj.

Arsintari e planifikon, projekton dhe e organizon procesin mësimor, por realizimi i mësimit në etikë nuk është i ashpër. Konceptioni i ndodhjes mësimore është i orientuar drejt paraqitjes së etikës si fushë e vullnetit të lirë të personalitetit dhe drejtë afirmimit të iniciativës së lirë dhe diskutimit me nxënësit. Nxënësi mëson të mendoj në mënyrë të pavarur. Zhvillimi i të menduarit të pavarur dhe të përgjegjshëm është detyra e parë e etikës, dhe sipas asaj edhe detyra e parë e mësimit etik. Ajo është parim i veçantë i mësimit të etikës dhe të metodikës të arsimit etik.

Momenti kyç në organizimin dhe realizimin e mësimit të etikës është tentimi i vazhdueshëm që nxënësit të mësojnë të zbulojnë dhe të njohin të mirën, të përcaktohen pér të mirën dhe të angazhohen të sjelljen mirë – t'ju ikin mendimeve të këqija, qëllimeve të këqija dhe veprave të këqija.

Në arsimin bashkëkohor notimi nuk është vetëm matje e thjesht e numrit të fakteve që gjatë ligjërimit do ti nxjerr nxënësi, por ai është vlerësimi (evalvimi) i zhvillimit dhe përparimit të nxënësve sipas qëllimeve të Programit mësimor.

Evalvimi bashkëkohor i tejkalon kontrollimet dhe notimet e njëanshme tradicionale të nxënësve, që do të zbres në verifikimin e shkallës së përvetësimit të njohurive formale sipas vërtetësisë së reproduksionit të materialit që prezantonhet para gjithë klasës, pas së cilës do të vijonte notimi numerik i kohë pas koheshim.

Elementet që vlerësohen gjatë formimit të notës në etikë janë të llojlojshme dhe shumë numërtua, ashtu që ofrojnë mundësi të mëdha edhe pér nxënësin edhe pér arsimtarin. Nuk duhet ti jepet prioritet shpjegimeve monologë të nxënësit në formën "përgjigje me nota". Në mësimin bashkëkohor pothuajse është larguar nga përdorimi shfrytëzimi i vetëm një elementi mbi të cilin do të formohet nota. Kombinimi i më tepër elementeve e thenë monotoninë e punës mësimore dhe mundëson formim të notës me të cilën do të janë të kënaqur edhe arsimtari edhe nxënësi.

Në mësimin praktik të etikës së klasës së VI, në formimin e notës duhet të niset nga këto elemente (të cilët formojnë portfolio adekuate të nxënësit):

- rregullshmëria në mësim;
- angazhimi i nxënësit ta përcjellë dhe ta përvetësojë materien mësimore;
- eksponimi i nxënësit në kuadër të dialogut;
- prezantimi monolog i nxënësit;
- punimi i rregullt i detyrave të shtëpisë;
- shpjegimi dhe ekspozimi i temave të dhënura.